



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR K U R B I N

RAPORTI VJETOR
I PUNËS SË PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN
PËR VITIN 2017

Analizat vjetore të punës janë moment i rëndësishëm në aktivitetin e institucioneve. Ato përveç vlerës informuese për aktivitetin një vjeçar të institucionit në tërësi, individualizojnë edhe veprimtarinë, aktivitetin dhe treguesit e gjithësecilit punonjës.

Veç kësaj, analizat vjetore të punës përfshijnë edhe momentin ballafaques të rezultatit të arritur nga institucioni në përgjithësi dhe nga secili punonjës në veçanti, me rezultatit të kërkuar apo me objektivat që ishin përcaktuar dhe pritshmeritë për vitin që analizohet. Por nëse kjo konsideratë, për analizat vjetore të punës vlen për të gjitha institucionet, për organin e Prokurorisë, për vitin 2017 që po analizojmë, ka vlerë dhe rëndësi të veçantë. Kjo për faktin, se viti 2017 solli ndryshime të mëdha dhe të rëndësishme ligjore, konceptuale dhe ndryshime në praktikën procedurale në tërësi.

Ndryshimet e rëndësishme kushtetuese të realizuara me Ligjin Nr. 76/2016, të shoqëruara me Ligjin Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë“ dhe me Ligjin Nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7905, Datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë“ të ndryshuar“, organin e Prokurorisë e vendosën përballë një sfide që kërkonte para së gjithash mendësi dhe koncepte të reja në të kuptuarit e misionit dhe detyrës kushtetuese të organit të Prokurorisë, dhe më pas mendësi dhe koncepte të reja për realizimin e këtij misioni.

Natyrisht, këtyre rrethanave u duhet shtuar edhe fakti se viti që po analizojmë, për shkak të zhvillimeve të shumta në kuadër të Reformës në Drejtësi, e vendosi organin e akuzës edhe më përballë qytetarëve dhe opinionit publik, me vlerësime dhe perceptime që në shumë raste nuk ishin inkurajuese dhe mbështetëse për prokurorët në misionin e tyre të vështirë, në luftën dhe përballjen e tyre me krimin dhe shkelësit e ligjit.

Gjithësesi, pavarësisht gjithë këtyre rrethanave dhe vështërsive me të cilat na përballi viti 2017, puna një vjeçare e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, duhet vlerësuar për të gjithë treguesit që u arritën në ndjekjen penale dhe përfaqesimin e akuzës në gjykim.

Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin e ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Përmbushja e detyrës kushtetuese natyrisht që ka kërkuar angazhim maksimal të të gjithë stafit të kësaj prokurorie dhe veçanërisht të prokurorëve, të cilët kanë drejtuar këtë veprimtari duke mbajtur dhe marrë në çdo rast edhe përgjegjësite.

Për vitin 2017, lufta kundër krimit të rënde dhe korrupsionit, ka qene drejtimi i parë dhe përparësi ne gjithë veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Përmbushja e këtij prioriteti është tentuar të realizohet nëpërmjet hetimeve të shpjeta dhe pa zvarritje të procedimeve penale të regjistruara për këto vepra penale, dërgimin e tyre në gjykatë dhe angazhimin për një gjykim të shpejte të autoreve të tyre, duke kërkuar në çdo rast ndëshkimin ligjor të autorëve të këtyre veprave penale.

- Gjatë vitit 2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Kurbin nga policia janë referuar 2 materiale per veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal dhe nderkohë kanë ardhur për kompetencë në këtë prokurori edhe dy procedime te tjera per ketë vepër penale. Pra, gjithsej janë ndjekur në hetim për këtë vit 4 procedime penale të cilat jane dërguar për gjykim, me 4 të pandehur, 3 prej të cilëve me masën e sigurimit “arrest ne burg”.

- Per veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, gjatë vitit 2017 janë regjistruar 9 procedime penale. Për këtë vepër janë dërguar për gjykim 2 procedime penale, me 3 të pandehur, 2 prej të cilëve me masën e sigurimit “arrest në burg”. Për 5 procedime penale të regjistruara për veprën penale te parashikuiar nga neni 248 i Kodit Penal është vendosur pushimi i hetimeve.

- Nga ILDKPKI është referuar 1 material për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive dhe “interesave privatë...”, parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal, i cili është dërguar për gjykim me një të pandehur.

- Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, gjatë vitit 2017 janë referuar nga policia 15 materiale dhe mbi këto materiale janë regjistruar 13 procedime penale si dhe kanë ardhur për kompetencë edhe dy procedime të

tjera për këtë vepër penale. Gjatë këtij viti janë dërguar për gjykim 11 procedime penale të regjistruar për këtë vepër penale, përfshirë këtu edhe 10 procedime të mbartura nga viti 2016 parë, me 20 të pandehur, 17 prej të cilëve me masën e sigurimit “arrest në burg”.

-Për vitin që po analizojmë, janë regjistruar 23 procedime penale për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Gjithsej për këtë vepër janë ndjekur 27 procedime penale, pasi 4 procedime ishin të mbartura nga viti i kaluar, dhe në përfundim është vendosur pezullimi i hetimeve për 18 procedime penale, dërgimi për gjykim i 4 procedimeve penale me 5 të pandehur, 4 prej të cilëve me masën e sigurimit “arrest në burg”.

- Gjatë vitit 2017, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka regjistruar 8 procedime penale, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, prej të cilëve për 1 procedim është vendosur pushimi i hetimeve, 1 procedim është transferuar dhe 1 procedim është dërguar për gjykim. Për 5 procedime penale të regjistruara për këtë vepër penale vazhdojnë hetimet.

Viti	Neni 244/259	Neni/248	Neni/257/a	Neni/283	Neni /284	Neni/287
2016	3	3	–	22	60	3
2017	4	9	1	17	23	8

Një numër i konsiderueshëm i procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2017, për veprat penale që ishin përparësi e punës tonë, nuk kanë marrë zgjidhje gjatë këtij viti. Kjo për faktin se këto procedime për vetë natyrën e veprave penale objekt hetimi, kërkojnë hetime komplekse dhe të thelluara, shtrirje të hetimeve, ekspertime kontabël, aplikimin e metodave speciale të hetimit shoqëruar edhe me hetime proaktive, dhe në shumë raste shoqërohen edhe me kërkime në shtete të tjera nëpërmjet letërporosive përgjigjet e të cilave zgjasin në kohë .

Gjithësesi, ndjekja dhe hetimi i këtyre procedimeve penale kërkon përmirsim dhe rritje të profesionalizmit të prokurorëve dhe veçanërisht të oficerëve të policisë gjyqësore. Është e nevojshme që oficerët e policisë gjyqësore të rikonceptojnë raportin me hetimin në këto procedime, për të mos ngelur vetëm si subjekte që plotësojnë në mënyrë mekanike detyrat e e

deleguara nga prokurorët në aktet e delegimit, por të mendojnë për kërkimet e mundëshme që duhen bërë gjatë hetimit, më qëllim gjetjen e provave, që për vetë natyrën e këtyre procedimeve nuk rezulton të jetë e lehtë.

Përmirsimet duhen bërë edhe në drejtim të bashkëpunimit me agjencitë e ndryshme ligjzbatuese, të cilat mund të ndihmojnë me potencialet që disponojnë për gjetjen e provave të nevojshme në procesin e hetimit për këto procedime penale.

Respektimi i të drejtave të njeriut.

Respektimi i të drejtave të njeriut, mbrojtja e këtyre të drejtave në rast të cënimit të tyre, ka qenë përparesi e gjithë punës dhe veprimtarisë së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Mbrojtja dhe respektimi i këtyrë të drejtave gjithmonë është konceptuar dhe realizuar në zbatimin korrekt të rregullimit ligjor dhe atij procedural penal për këto çështje.

Rëndësi i është kushtuar edhe bashkëpunimit me institucionet e tjara, me qëllim hetimin e shpejtë të veprave penale në këtë fushë, dhënien e zgjidhjeve të drejta dhe të bazuara në prova dhe në ligj, në kohë sa më të shpejtë, dhe parandalimin e pasojave kriminale.

Respektimin e të drejtave të ligjshme të qytetarëve dhe mbrojtjen e lirive themelore të tyre duke garantuar në çdo rast procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, ne e kemi parë si detyrim kushtetues.

Të miturit dhe grupet vunerabël, si të pandehur dhe viktimat.

Vëmendje dhe kujdes i veçantë në punën tonë i kemi kushtuar edhe trajtimin të të miturve dhe grupeve të tjera vunerabël të cilët gjatë vitit 2017 kanë rezultuar të jenë të demtuar- viktimat të veprave penale apo edhe autor të pandehur në procedimet penale. Në trajtimin e këtyre grupeve kemi respektuar parashikimet dhe rregullimet që bën ligji procedural penal si dhe urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.

Vëmendje në këto raste i është kushtuar caktimit të masave të sigurimit personal duke aplikuar masa sigurimi ndryshe nga ajo e arrestit në brug si dhe më pas duke kërkuar dënime alternative në gjykatë.

Gjatë vitit 2017, janë regjistruar 15 procedime penale me autor të mitur, të moshës nga 14-18 vjeç, për të cilët pas kryerjes së veprimeve të para procedurale dhe caktimit të masës së

sigurimit personal, e cila ka qenë e ndryshme nga ajo e arrestit ne burg, është vendosur shpallja e moskompetencës për keto procedime dhe kalimi i akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si prokuroi kompetente për hetimin e tyre.

Me hyrjen në fuqi të Kodit për të Mitur me 1 janar te këtij viti, ndjekja e procedimeve penale me të mitur ka pësuar ndryshime të rëndësishme proceduriale, si për sa i takon kompetencës për hetimin e ketyre procedimeve, ashtu edhe mënyres së trajtimit të viktimave dhe të pandehurve të mitur, të drejtat që atyre duhet tu respektohen, masat e sigurimit që aplikohen ndaj të pandehurve të mitur, procedurës së gjykimit të të pandehurve të mitur dhe dënimet ndaj tyre. Tani jemi në një situatë pothuaj tërësisht të re në këtë fushë, e cila para së gjithash kërkon njohje të mirë të Kodit për të Mitur, me qëllim që të mund të përshtasim edhe koncepte dhe praktika të drejta dhe ligjore në ndjekjen e procedimeve me të mitur.

Përhapje të gjërë e me tendencë rritje, vazhdon të ketë vepra penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Gjatë vitit 2017, u regjistruan 34 procedime për këtë vepër penale, me 34 të pandehur, të gjithë me masën e sigurimit “arrest në burg”. Për këtë vepër penale u ndoqën gjithsej në hetim 41 procedime penale, pasi 7 procedime ishin të mbartura nga viti 2016. Duhet thënë se nuk ka patur asnjë pushim për procedimet penale të regjistruara për këtë vepër penale, dhe në përfundim janë derguar për gjykim 35 procedime penale, me 35 të pandehur, të gjithë me masën e sigurimit personal “arrest ne burg”.

Nese do të bëjme një krahasim me një vit më pare, pra me vitin 2016, do të vëmë re se numri i procedimeve penale të regjistruara për këtë veper penale ka ardhur ne rritje, me 8 procedime penale më shumë. Për vitin 2016 u regjistruan 26 procedime penale dhe u ndoqën ne hetim 33 procedime penale, pasi 4 procedime ishin të mbartura nga viti 2015.

Siç shihet edhe nga treguesit që janë shënuar për këtë vepër penale, ne jemi përpjekur ti hetojmë me shpejtësi këto procedime penale, me qëllim parandalimin e pasojave që mund të jene të natyrave të ndryshme. Për vetë natyrën e konfliktit dhe pasojat që ato sjellin, pothuaj në të gjitha rastet kemi aplikuar masën e sigurimit “arrest ne burg”, si dhe kemi kërkuar dënime ligjore në raport të drejtë me marëdhënien juridike që është shkelur, me pasojën e shkaktuar, me përhapjen e gjërë të kesaj vepre penale si dhe me tendencen në rritje të saj.

Natyrisht, rritja e numrit të procedimeve penale për këtë vepër penale ka shkaqe dhe rrethana të ndryshme, të natyrës ekonomike, sociale, nivelit emancipues që shoqeria jonë ka në këtë stad, etj.

Bashkëpunimi ndërinstitucional.

Raporti me Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës dhe Zyren e tij.

Përmbushja e detyrës kushtetuese dhe ligjore të organit të prokurorisë, natyrisht që shoqërohet edhe me nxjerrjen e urdhërave dhe udhëzimeve të ndryshme nga Prokurori i Përgjithshëm. Zbatimi i këtyre urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm edhe gjatë vitit 2017 ka qenë në fokus të punës së prokurorëve, me qëllim mbarëvajtjen e saj dhe zbatimin korrekt të ligjit penal procedural. Këto urdhëra dhe udhëzime janë punuar edhe me oficerë të policisë gjyqësore duke orjentuar dhe kërkuar në çdo kohë zbatimin e drejtë të tyre.

Vëmendje dhe vlerësim i është kushtuar edhe bashkëpunimit me drejtoritë e ndryshme të Prokurorisë së Përgjithshme, për t'ju përgjigjur në kohë kërtimeve të tyre dhe angazhimeve të ndryshme që ato kanë sugjeruar dhe orjentuar.

Raporti me Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhe dhe me Komisaratin e Policisë Kurbin.

Bashkëpunimi me këto institucione ka qenë shumë intensiv dhe gjithmonë i drejtë dhe ligjor. Këto dy institucione edhe për vitin 2017 kanë qënë referuesit kryesor të veprave penale në prokurori. Ato kanë referuar 704 kallëzime ose 85.5% e të gjithë referimeve dhe kallëzimeve që u administruan gjatë vitit 2017 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Marëdhënia me këto dy institucione ka qënë e vazhdueshme për shkak se edhe pas referimit të materialeve, në shumicën e tyre, hetimi ju është ngarkuar oficerëve të policisë gjyqësore të këtyre dy subjekteve. Për këtë arsye, më këto dy institucione komunikimi ka qënë i vazhdueshëm, i bazuar në rregullimin procedural penal, me qëllim realizimin e ndjekjes penale nëpërmjet evidentimit dhe dokumentimit të plotë të veprave penale, vënien e autorëve para përgjegjësisë penale dhe ndëshkimit të tyre sipas ligjit, me qëllim parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale në të ardhmen.

Në këtë bashkëpunim, kujdes i veçantë është treguar për dhënien e udhëzimeve të drejta, delegimit të detyrave të detajuara për oficerët e policisë gjyqësore në strukturat e policisë së shtetit për procedimet penale që u janë deleguar, për hetimin e çështjeve penale të referuara nga ana e tyre. Gjithashtu oficerët e policisë gjyqësore të strukturave të policisë së shtetit, në takimet e ndryshme që janë organizuar me ta, janë njohur edhe me kuadrin ligjor të ndryshuar të ligjit penal dhe atij procedural penal.

Raporti me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Bashkëpunimi me Gjykatën ka qenë korrekt dhe i bazuar ne rregullimet përkatëse ligjore, në funksion të përmbushjes se misonit dhe detyrës kushtetuese te secilit organ.

Prokurorët kanë vlerësuar gjithmonë detyrimin për te qene te pranishëm në seancat gjyqësore duke respektuar etikën në veshje, paraqitje dhe gjithë qëndrimin në seance dhe në ambjentet e gjykatës.

Vlëresojmë punën dhe korrektesën e gjykatës në komunikimet me Prokurorinë, si për njoftimet e ndryshme te seancave gjyqësore ashtu edhe për sjelljen në kohë të vendimeve gjyqësore me ekzekutim të menjëhershëm apo edhe të vendimeve gjyqësore të formës se prerë.

Raporti me Institucionet e tjera.

Prokuroria në funksion të realizimit të detyrës kushtetuese të saj ka bashkëpunuar edhe me shumë institucione të tjera lokale dhe qëndrore, si me Zyrën Përmbartimore, Zyrën e Shërbimit të Proves, IEV Penale Lezhe, etj. Bashkëpunimi me këto institucione kryesisht ka qenë në funksion të ekzekutimit te vendimeve te ndryshme penale, nëpërmjet nxjerrjes dhe dërgimit në këto institucione të urdhërave të ekzekutimit për këto vendime penale dhe ndjekjes në vazhdimësi të ekzekutimit dhe zbatimit të dënimeve penale, kohën e provës etj.

Gjatë vitit 2017, në ekzekutim të vendimeve gjyqësore nga ana e prokurorëve, janë nxjerrë 210 urdhëra ekzekutimi lidhur me dënimet me burgim, dënimet me gjobë, dënimet alternative, provat materiale, shpenzimet proceduriale, etj.

Prokuroria, natyrisht ka bashkëpunuar edhe me institucione të tjera, të cilave ju është drejtuar me kërkesa te ndryshme për fakte dhe rrethana që ato dispononin lidhur me faktet objekt hetimi. Komunikim të dendur kemi patur me kompanitë e telefonisë celulare, të cilat jo gjithmonë u janë pergjigjur në kohë kërkesave tona, duke u bere shkak në shumë raste edhe për zvarritje të pajustificuara të hetimeve të shumë procedimeve penale.

Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Ligji procedural penal dhe Ligji për Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë, e ngarkon prokurorinë edhe si subjekt të bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore ndërkombëtare. Ky bashkëpunim është arritur nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë vitit 2017, Prokuroria Kurbin ka vënë në lëvizje 3 kërkesa te autoriteteve të huaja gjyqësore për njohje të vendimeve të tyre gjyqësore, duke ju drejtuar gjykatës me kërkesat përkatëse dhe më pas me vënien në ekzekutim të këtyre vendimeve.

Gjithashtu gjatë këtij viti nga ana jonë ju është kërkuar autoritetve të huaja ekstradimi i një të dënuari, si dhe i kemi dhënë rrugë kërkesës të një autoriteti të huaj gjyqësor për një ekstradim.

Po kështu, janë ekzekutuar 12 letërporosi të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për njoftimin e dëshmitarëve, njoftimin e të pandehurve, njoftimin e vendimeve penale të gjykatave të huaja, etj, si dhe janë dërguar 2 letërporosi autoriteteve të huaja.

Perdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimet proaktive.

Përdorimi i metodave dhe teknikave të posaçme të hetimit është i rregulluar me ligjin procedural penal për veprimet stimuluese, përgjimet e telekomunikimeve, etj. Përdorimi i këtyre metodave diktohet nga specifika që kanë procedimet penale për një sërë veprash penale, të cilat kërkojnë kapjen e fakteve dhe rrethanave provuese në mënyrë të shpejtë, në fazë të ndryshme të procesit kriminal, në kohë dhe vende të ndryshme, si dhe tek persona të ndryshëm, të cilët bashkëpunojnë njëkohësisht për realizimin e veprës penale por duke qënë në vende të ndryshme.

Në shumë raste, për të mos thënë dënuar, janë vendosur përgjime të telekomunikimeve për të identifikuar autorët e veprave penale në rastet e krimeve të rënda kundër jetës dhe personit. Rezultatet e marra nuk kanë qënë të vlerësueshme, ç'ka do të thotë se ose nuk kemi identifikuar mirë personat dhe marrëdhëniet e tyre me personat e tjerë, ose nuk i kemi realizuar mirë këto veprime.

Në vazhdim duhet të përmirsohet dhe të intensifikohet puna në drejtim të përdorimit të metodave speciale të hetimit për vetë natyrën e disa procedimeve të regjistruara këtë vit, ashtu edhe për faktin se krimi i organizuar dhe krimi në përgjithësi po avancojnë dhe po bëhet gjithnjë e më konspirativ.

Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, të nxjerra në bazë të tyre.

Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit dhe krimin të organizuar si dhe i urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, është shoqëruar me një gjendje të qëndrueshme në tregues relativisht të ulët të kriminalitetit për veprat penale të rënda si vrasjet, vjedhjet me armë dhe korrupsionit. Ndërsa për veprën penale të shpërdorimit të detyres dhe trafikimit të mjeteve motorrike ka patur rritje të numrit të referimeve si nga policia ashtu edhe nga qytetarët.

Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale “Vrasja me paramendim”, parashikuar nga neni 78/1 i Kodit Penal, dhe një procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 79/ “ë” të Kodit Penal, pra gjithësej 3 procedime penale.

Një vit më parë, për veprat penale të vrasjes u regjistruan 4 procedime penale, 2 për veprën penale të parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal, 1 procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe 1 procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 79/“ë” i Kodit Penal.

Për veprën penale të vjedhjes me dhunë dhe vjedhjes me armë, për vitin 2017 janë regjistruar 5 procedime penale, numër i njëjtë me atë të një viti më parë.

Për veprën penale të trafikimit të mjeteve motorrike, gjatë vitit 2017 janë regjistruar 4 procedime penale, ndërsa një vit më parë, për këtë veprë penale ishte regjistruar vetëm 1 procedim penal.

Gjatë vitit 2017, rritje ka pësuar numri i rasteve të vetëvrasjeve dhe vetëmbytjeve, të cilat kanë shkaqe të ndryshme si ekonomike, sociale, familjare, etj. Për këtë vit, janë referuar në prokurori 35 raste të tilla, nga 29 që u referuan një vit më parë. Në 34 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal dhe vetëm për një rast është regjistruar procedim penal, dhe në përfundim të hetimeve edhe për këtë procedim është vendosur pushimi i hetimeve.

Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike.

Gjatë vitit 2017, janë regjistruar 3 procedime penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike, sipas Ligjit nr.138/2015.

Materialet janë referuar nga Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme. Këto procedime janë hetuar me shpejtësi dhe në përfundim janë dërguar për gjykim. Në një rast nga gjykata është vendosur pushimi i gjykimit. Ky vendim i gjykatës është ankimuar nga ana jonë, por nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata e Apelit.

Problematikat e hasura.

Viti 2017 me veçantitë që pati, natyrisht do të shoqërohej edhe me probleme e shqetësime të ndryshme, analizimi i të cilave po bëhet nëpërmjet gjithë parashtrimit të punës dhe treguesve të shënuar në këtë vit.

Por, gjithësesi mendojmë se ndryshimet e mëdha që pësoi Kodi i Procedrës Penale, duke vendosur normime të reja në ndjekjen penale dhe përfaqesimin e akuzes në gjykim, duke krijuar subjekte dhe figura të reja procedurale, ishte edhe sfida më e fortë me të cilën u përballëm. Njohja dhe përvetësimi i këtyre ndryshimeve duhesh bërë njëkohësisht me vazhdimin e ushtrimit të ndjekjes penale sipas këtyre normimeve të reja. Pa menduar se kjo është arritur në nivelin më të mirë, mendojmë se treguesit në këtë drejtim kanë qenë të kënaqshëm.

Në vazhdim duhen shënuar përmirësime edhe në punën e policisë gjyqësore, duhet rritur profesionalizmi i tyre, pasi me të lidhet edhe rezultati i hetimit të procedimeve penale që u delegohen, të cilat jo vetëm janë të shumtë në numër, por janë edhe procedime për vepra të rënda penale dhe me impakt në opinionin publik, lidhur me perceptimin që opinionin publik krijon për luftën e agjencive ligjzbatuese kundër krimit të rënde, krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodi për të Mitur, kërkojnë edhe krijimin e ambjenteve dhe vendosjen e mjeteve teknike të përshtatshme, me qëllim që veprimet me të mitur të kryhen sipas këtyre normimeve.

Treguesit e ndjekjes penale dhe të përfaqësimit të akuzës në gjykim për vitin 2017.

Gjatë 2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini ka administruar 795 kallëzime, referime për vepra penale dhe materiale të tjera të ardhura nga policia e shtetit, nga shtetas të ndryshëm, nga prokurori të tjera dhe nga Prokuroria e Përgjithshme. Të gjitha referimet janë regjistruar në Regjistrin e Kallëzimeve Penale, janë hedhur në short dhe u kanë kaluar menjëherë për veprim prokurorëve, për vlerësim dhe disponimin ligjor të mëtejshëm. Prokurorët pasi kanë studjuar faktin objekt referimi dhe aktet e administruara në këto kallëzime dhe referime, për 531 kallëzime kanë urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, pasi kanë gjetur kushtet ligjore të parashikuara nga neni 287 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjatë vitit 2017, janë ndjekur në hetim edhe 79 procedime penale të mbartura nga një vit më parë, pra nga viti 2016, si dhe janë studjuar një numër i konsiderueshëm procedimesh penale të pezulluara ndër vite, duke kryer veprimet procedurale të konstatimit të parashkrimit të ndjekjes penale për 31 procedime penale. Për këto procedime të rifilluara për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, ndryshe nga praktikat e mëparshme të trajtimit procedural, është ndjekur procedura e ndryshuar, i kemi kërkuar gjykatës të vendos për pushimin e tyre. Gjatë këtij viti kanë ardhur me transferim nga prokurori të tjera edhe 7 procedime penale, dhe në total numri i procedimeve të ndjekura në hetim për vitin 2017 rezulton të jetë 649 procedime penale.

Gjatë vitit që po analizojmë, nga prokurorët është përfaqësuar akuza në gjykim për një numër të madh procedimesh penale, duke u përfunduar gjykimi për 204 çështje penale.

Këto janë treguesit e volumit të punës që është përballuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbini gjatë vitit 2017. Nëse këta tregues, do të krahasojmë me ato të një viti më parë, pra me vitin 2016, do të konstatojmë se kemi një gjendje pothuaj të njëjtë treguesish për sa i përket numrit të kallëzimeve dhe procedimeve penale të regjistruara dhe të ndjekura në hetim në këto dy vite.


Gjatë vitit 2017, siç theksuam edhe më lartë, është bërë regjistrimi në Regjistrin e Kallëzimeve Penale për 795 kallëzime dhe referime, ndërsa për vitin 2016 janë regjistruar 817 kallëzime. Në regjistrin e Procedimeve Penale, gjatë vitit 2017 janë regjistruar 531 procedime penale, ndërsa për vitin 2016 u regjistruan 501 procedime penale. Gjatë vitit 2017 janë ndjekur në hetim në total 649 procedime penale, ndërsa për vitin 2016 janë ndjekur në total 652 procedime penale.

Edhe treguesi i përfaqësimit të akuzës në gjykim rezulton të jetë pothuaj i njëjtë me atë të një viti më parë. Gjatë vitit 2017 përfundoi gjykimi i 204 çështjeve penale, ndërsa gjatë vitit 2016 përfundoi gjykimi i 209 çështjeve penale.

Tabela më poshtë pasqyron këta tregues sipas zërave që trajtuam më sipër për dy vitet, për vitin 2016 dhe vitin 2017.


Vitet	Kallezime	Mbartur proced	Regjist. proc	Ardhur me transf	Rifilluar	Gjithsej proced	Përf. gjykimi
2016	819	147	501	4	-	652	209
2017	795	79	531	7	32	649	204

Ndërsa në mënyrë grafike do të kishim këtë paraqitje për volumin e punës të ndjekur në dy vitet, 2016 dhe 2017.



Gjatë vitit 2017, pas vlerësimit paraprak të akteve, prokurorët kane vendosur mosfillimin e procedimit per 277 kallëzime penale, pasi kanë gjetur kushtet ligjore të parashikuara nga neni 290 i Kodit te Procedures Penale. Ky tregues i krahasuar me atë të një viti më parë rezulton të jëtë më i lartë, pasi gjatë vitit 2016 mosfillimi procedimit penal është vendosur per 226 kallëzime penale, pra 51 vendime mosfillimi me shumë gjatë vititi 2017.

Paraqitja grafike tregon raportin e kallëzimeve dhe referime për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit më kallëzimët e trajtuara në tërësi gjatë vitit 2017.



Trajtimi i kësaj zgjidhje ligjore mendoj se meriton vëmendje pasi për shkak të normimit te afatit 15 ditor për vendosjen e mosfillimit për kallëzimet penale, problemi i administrimit të akteve të ndryshme, vecanerisht atyre mjekoligjore, kërkon trajtim dhe zgjidhje nderinstitucionale. Kjo për faktin se në këtë proces hyjnë dhe ndërveprojnë disa institucione.

Policia gjyqësore dërgon vendimet e ekspertimit tek Mjekësia Ligjore, të dëmtuarit ne shumicën e rasteve dërgohen për trajtim në Spitalin e Traumës Tiranë por edhe në qendra të tjera spitalore. Ekzaminimi i tyre kryhet nga ekspertët mjekoligjor nëpërmjet shyrtimit të kartelave mjekësore, por në shumë raste kërkohet nga eksprtët edhe këqyrja fizike e të

dëmtuarve. Më pas ekspertët përpilojnë aktin mjekoligjor, të cilin e administrojnë pranë institucionit të tyre dhe pas kësaj administrata e këtij institucioni i dërgon aktet pranë prokurorive, por në shumë raste edhe pranë policive që kanë derguar vendimet për ekzaminim mjeko ligjor. Ka rastë që ekspertët mjekoligjor për të konkluduar presin daljen edhe të rezultateve të ekzaminimeve toksikologjike që kërkojnë një kohë më të gjatë.

Në gjithë këtë proces, a është realisht e mundur që prokurori të respektoj afatin 15 ditor tashmë të normuar nga Kodi i Procedurës Penale për të vendosur mosfillimin e procedimit për referimet dhe kallëzimet e ndryshme, për të cilat rezulton se gjenden kushtet ligjore për këtë zgjidhje? Ndodhur në këtë situatë, prokurori vihet në vështërsi të madhe për të administruar aktet që rezultojnë të nevojshme dhe respektimin e afatit 15 ditor.

Gjatë vitit 2017, është vendosur pushimi i procedimit penal për 67 procedime penale. Në këtë tregues janë përfshirë edhe 31 procedimet penale të dërguara në gjykatë për vendosjen e pushimit për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Pra, rezulton se pushimi i hetimeve këtë vit është vendosur vetëm për 36 procedime penale nga procedimet penale që u noqen në hetimgjatë vitit 2017. Krahasuar me treguesin e një viti më parë, rezulton se gjatë vitit 2017 kjo zgjidhje është vendosur për më pak procedime. Gjatë vitit 2016 pushimi i hetimeve është vendosur për 78 procedime penale, pra për 42 procedime më shumë.

Gjatë vitit 2017, është vendosur pezullimi i hetimeve për 219 procedime penale, për shkak se pas hetimit të kryer për keto procedime penale, nuk është bërë e mundur të identifikohen autorët e veprave penale.


Krahasuar me një vit më parë, kjo zgjidhje ligjore rezulton të jete në shifra pothuaj të njejta. Gjatë vitit 2016 pezullimi i hetimeve është vendosur për 220 procedime penale.

Nëse këtë tregues do ta analizojmë duke e krahasuar me numrin e procedimeve penale që kanë marrë zgjidhje për vitin 2016 edhe për vitin 2017, do vëmë re se ky numër është i lartë.

Gjatë vitit 2016 kanë marrë zgjidhje 546 procedime penale dhe nga këto për 220 procedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve. Numri i procedimeve për të cilat është vendosur pezullimi i hetimeve për vitin 2016 rezulton të jetë 40% e gjithë numrit të procedimeve që kanë marrë zgjidhje në këtë vit.

Ndërsa për vitin 2017, pezullimi i hetimeve është vendosur për 219 procedime penale nga 534 procedime që morën zgjidhje në këtë vit. Nëse këtij numri do të zbrisim numrin e

procedimeve të rifilluara për parashkrim, atëherë rezulton se pezullimet e hetimeve për vitin 2017 përbëjnë 43% të numrit të procedimeve që kanë marrë zgjidhje këtë vit.



Natyrisht që ky tregues meriton vlerësim dhe trajtim të posaçëm si nga në prokurorët që ndjekim hetimin dhe jemi përgjegjës për to, ashtu edhe nga policia gjyqesore e strukturave të policisë së shtetit që ndjek hetimet e procedimeve penale.

Treguesi i procedimeve penale të pezulluara është treguesi i zbulueshmërisë së krimit, i cili përveç tjerash ka edhe një impakt të rëndë në shoqëri, pasi prek direkt qytetarët e dëmtuar dhe të cënuar ekonomikisht, fizikisht në shëndet dhe në jetën e tyre apo të familjarëve të tyre nga veprat penale.


E ngritëm këtë problem nisur edhe nga një tregues tjetër, ai i rifillimit të procedimeve penale për shkak se janë gjetur të dhëna që identifikojnë autorin e veprës penale. Gjatë vitit 2016 nuk ka patur asnjë rifillim për këtë shkak, dhe gjatë vitit 2017 vetëm për një procedim penal është vendosur rifillimi i hetimeve, pasi nga ndjekja e tij rezultuan të dhëna identifikuese më gjurmë datiloskopike për autorin e një vjedhjeje.

Gjatë vitit 2017, prokurorët kanë konstatuar moskompetencën për hetimin e 25 procedimeve penale, prandaj dhe kanë vendosur kalimin e akteve për këto procedime prokurorive të tjera. Procedimet me të mitur zënë numrin më të madh të procedimeve të transferuara, për shkak të kompetencës për ndjekjen e tyre nga Seksioni për të Mitur në Prokurorinë e Rrethit

Gjyqësor Tiranë. Hyrja ne fuqi e Kodit për të Mitur me 1 janar të këtij viti ka ndryshuar këtë rregullim, pasi tani procedimet me të mitur do të ndiqen nga prokuroria ku ndodh fakti penal. Nëse këtë tregues do ta krahasonim me atë të një viti më parë, konstatojmë së ai pothuaj është i njejtë. Gjatë vitit 2016 moskompetenca në hetim është vendosur për 27 procedime penale.

Gjatë vitit 2017, prokurorët kanë vendosur dërgimin në gjykatë për 223 procedime penale, nga 243 procedime penale që u derguan për gjykim gjatë vitit 2016. Pra, sic shihet ky tregues ka rënie këtë vit, me 20 procedime më pak. Por lidhur me këtë tregues duhet të sqarohet se ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale kanë ndikuar në këtë drejtim, pasi kjo zgjidhje tashmë rezulton të paraqitet më e vunuar nga mbyllja e vitit kalendarik. Kjo për faktin se shumë kërkesa të dërguara nga prokurorët ne gjykatë për dërgimin në gjykim të procedimeve penale, nuk u shqyrtuan brenda muajit dhjetor të vitit 2017 edhe pse në gjykatë kërkesat u administruan brenda atij viti.

Paraqitja grafike shpreh raportin mes mosfillimeve, pezullimeve dhe pushimeve ne kuadër te gjithë procedimeve që kanë marrë zgjidhje gjatë vitit 2017.



Nga viti 2017, u mbarten ne hetim 115 procedime penale nga 79 procedime penale që ishin mbartur nga viti 2016. Edhe këtu vlen i njejtë sqarim, pasi në numrin e procedimeve penale të mbartura nga viti 2017 është përfshirë edhe numri i procedimeve te rifilluara për shkak të

parashkrimit të ndjekjes penale, por që kërkesat për pushim nuk ishin gjykuar nga gjykata deri me 31 dhjetor 2017, si dhe është përfshirë numri i disa procedimeve penale për të cilat prokurorët kishin konkluduar për pushimin e hetimeve, por kërkesat për pushim nuk ishin shlyrtuar ende deri me datë 31.12.2017. Pra, numri i procedimeve penale të mbartura nga viti 2017 është më i ulët se numri që ka rezultuar në statistikë prej 115 procedimeve penale.

Tabela pasqyron zgjidhjet e dhëna për vitin 2017 e krahasuar edhe me ato të dhëna për vitin 2016.

Vitet	Mosfillim	Pushim	Pezullim	Transf	Gjykate	Perfund/ Proced	Mbartur
2016	226	83	220	27	243	573	79
2017	277	67	219	25	223	534	115

Efektiviteti i ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim gjatë vitit 2017.

Për vitin 2017, numrin më të madh të kallëzimeve e ka referuar policia e shtetit. Nga ky subjekt, Komisariati i Policisë Kurbin dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, për vitin 2017 janë referuar 704 kallëzime ose 85.5% e të gjithë kallëzimeve që u regjistruan në këtë vit.

Kallëzimet e referuara nga policia e shtetit gjatë vitit 2017 janë për vepra të ndryshme penale të kryera në rrethin e Kurbinit. Referimet e këtij subjekti janë për vepra penale me vendngjarje, për fakte dhe ngjarje të ndryshme për të cilat ky subjekt ka ardhur në dijeni, si dhe për ngjarje e fakte të kallëzuar nga shtetas të ndryshëm pranë këtij subjekti.

Gjatë vitit 2017, në prokurori janë administruar 84 kallëzime penale nga shtetas të ndryshëm, me objekt kryesisht konfliktet e pronësive mbi tokën. Edhe pse ky numër në raport me numrin e përgjithshëm të kallëzimeve dhe të materialeve që janë referuar për këtë vit në prokurori, përbën vetëm 10.5% të tij, është për tu vlerësuar si rritje e besimit të qytetarëve tek prokuroria si organ i ndjekjes penale.

Edhe statistika e vititi 2017 lidhur me kallezimet dhe referimet nga policite e tjera gjyqësore dhe nga institucionet e ndryshme shtetërore është e njëjtë me atë të disa viteve më parë. Kallëzimet nga këto subjekte vazhdojnë të mungojnë. Në statistikë shënohen vetëm 7 kallëzime nga nëpunësit publik, ku 3 prej tyre janë nga Prokurorisa e Përgjithshme.

Referimet dhe kallëzimet e ndryshme, në çdo rast, janë vlerësuar me vëmendje dhe seriozitet nga prokurorët dhe mbi gjendjen e akteve është orjentuar edhe trajtimi i tyre.

Për 277 kallëzime dhe referime, siç parashtruan edhe me sipër, prokuroret pasi kanë administruar aktet e nevojshme dhe kanë kryer veprimet e nevojshme verifikuese, kanë vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi kanë gjetur kushtet ligjore të parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale.

Nëse do të shikonim mosfillimet sipas grup veprave për të cilat janë referuar materialet, numrin më të madh e zënë mosfillimet e vendosura për referimet e bëra për veprën penale të parashikuar nga neni 290/1, gjithsej 39 mosfillime, ato për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, gjithsej 34 mosfillime, ato të vendosura për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, gjithsej 23 mosfillime, ato të vendosura për veprat penale të parashikuara nga nenet 150, 151 dhe 248 i Kodit Penal, nga 18 mosfillime për secilën veprë, mosfillimet e vendosura për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, gjithsej 15 mosfillim dhe 3 mosfillime për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

Le të shohim këta tregues të pasqyruar në tabelë dhe të krahasuar me treguesit e një viti më parë.

Vitet	Neni 290/1	Neni 99	Neni 84	Neni 150	Neni 151	Neni 248	Neni 277	Neni 89	Neni 90
2016	23	27	22	11	7	20	20	10	14
2017	39	34	23	18	18	18	13	3	15

Siç shihet edhe nga tabela statistikore, ka pësuar rritje të ndjeshme numri i mosfillimeve të vendosura për veprën penale “Shkaktimi i vetevrasjes“, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, - 27 mosfillime të vendosura gjatë vitit 2016 dhe 34 mosfillime gjatë vitit 2017, ato të vendosura për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, 23 mosfillime të vendosura gjatë vitit 2016 dhe 39 mosfillime të

vendosura gjatë vitit 2017. Te dy këto vepra penale, shoqërohen me demtime të shëndetit dhe jetës, por vecanërisht ajo e parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, e cila në shumë raste është e shoqëruar me humbje te jetës.

Në të gjitha rastet, kur prokurorët kanë vendosur mosfillimin e procedimit penal është bërë njoftimi i vendimit personit apo subjektit që ka bërë kallëzimin dhe personave ndaj të cilëve është bërë kallëzimi. Natyrisht në gjykatë janë administruar ankime te kallëzuesve dhe gjykata në 7 raste ka vendosur shfuqizimin e vendimit te mosfillimit dhe ka udhëruar regjistrimin e procedimit penal. Sipas prokurorëe këto vendime shfuqizimi ndahen: - 3 raste janë vendime të prokurorës Ajola Preençi dhe 4 raste janë vendime te prokurorit Bardhyl Shehu. Ndaj këtyre vendimeve prokurorët kanë bërë ankime ne Gjykatën e Apelit por nga rastet e gjykuara nga kjo gjykatë nuk është ndryshuar vendimi i gjykeses se shkallës së parë në favor të ankimit te prokurorit.

Gjatë vitit 2017, u ndoqën në hetim 649 procedime penale. Gjatë hetimit të këtyre procedimeve janë marrë me cilesine e personit nën hetim 88 persona dhe në përfundim janë marrë me cilesinë e të pandehurit 271 persona. Me masën e arrestit në burg për këtë vit janë ndjekur 183 të pandehur.

Krahasuar me vitin 2016, këto tregues rezultojnë të jenë pothuaj të njejte. Jane ndjekur në hetim 652 procedime penale, janë pyetur me cilesinë e personave ndaj të cilit zhvillohen hetime 63 persona, janë marrë të pandehur 275 persona dhe janë ndjekur me masën e sigurimit arrest në burg 128 të pandehur.

Vitet	Procedime në hetim	Persona nën hetim	Të pandehur	Ndjekur me arrest. burg
2016	652	63	128	128
2017	649	88	183	183

Gjatë vitit 2017, rezulton se është dhënë zgjidhja ligjore për 534 procedime penale, me 24 persona nën hetim, 262 të pandehur, nga të cilët 162 janë ndjekur me masën e arrestit në burg.

Krahasuar me vitin 2016, këto tregues kanë këtë paraqitje. Është dhënë zgjidhje ligjore për 573 procedime, me 38 persona nën hetim, me 272 të pandehur, 114 prej të cilëve janë ndjekur me masën e sigurimit “arrest ne burg”.

Në mbyllje të vitit 2017 kanë mbetur në hetim 115 procedime penale, me 64 persona nën hetim, 9 të pandehur, 21 me masën e sigurimit “arrest ne burg”.

Këto tregues për vitin 2016 rezultojnë të jenë: 79 procedime të mbartura, me 28 persona nën hetim, 3 të pandehur, 14 me masën e sigurimit “arrest ne burg”.

Vitet	Zgjidhur	P/nen hetim	Pandehur	Arrest burg	Mbartur	P/nen hetim	Pandehur	Arrest ne burg
2016	573	38	272	114	79	28	3	14
2017	534	24	262	162	115	64	9	21

Vepra penale me përhapje më të gjërë edhe për vitin 2017 vazhdon të mbetet ajo e vjedhjes, parashikuar nga neni 134 i Koidt Penal. Gjatë vitit 2017 u regjistruan 155 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Penal, 31 procedime me shumë se në vitin 2016. Gjithashtu gjatë këtij viti u ndoqen në hetim edhe 17 procedime penale për këtë veprë penale që ishin mbartur nga viti 2016.

Në tërësi ju është dhënë zgjidhje 170 procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale, ku për 147 procedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve.

Gjatë vitit 2017 janë dërguar për gjykim 8 procedime penale të regjistruar për këtë veprë penale, me 13 të pandehur me masën e sigurimit “arrest ne burg”. Janë transferuar 8 procedime penale, kryesisht seksionit për të mitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është vendosur pushimi për 9 procedime penale që janë procedime të rifilluara dhe pushimi rezulton të jetë vendosur për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Për vitin 2016, rezulton se për këtë veprë penale janë zgjidhur 130 procedime penale, ku për 123 procedime është vendosur pezullimi i hetimeve, transferuar 3 procedime dhe dërguar në gjykatë 5 procedime penale.

Vitet	Mbartur	Regjist	Pezull	Transf	Pushuar	Gjykate	Zgjidhur
2016	29	124	123	3	2	5	130
2017	17	155	147	8	9	8	170

Por, ndërsa vjedhja është krimi me përhapje më të madhe dhe me tendencë rritje, zbulueshmëria e autorëve të kësaj veprë penale është mjaft e ulët. Për këtë veprë nuk rezultojnë të këtë pushim procedimi apo pushim të hetimeve të personave nën hetim. Përgjithësisht, procedimet për këtë veprë penale raportohen në Prokurori pa autor, apo pa dyshime konkrete për autor të mundshëm. Edhe nga hetimi më pas nuk sigurohen të dhëna për autorët e veprave penale, dhe në përfundim të hetimeve, raportohet pezullimi i procedimeve penale për moszbulim të autorëve.

Rritje për vitin 2017 ka shënuar edhe vepra penale “Ndertimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Gjatë vitit 2017 u regjistruan 42 procedime penale për këtë veprë, nga 21 procedime që ishin regjistruar për vitin 2016.

Rritje ka pësuar vepra penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Për këtë veprë u regjistruan 34 procedime penale nga 29 procedime që ishin regjistruar gjatë vitit 2016.

Edhe vepra penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal ka pësuar rritje të ndjeshme gjatë vitit 2017. U regjistruan 22 procedime penale për këtë veprë nga 3 që ishin regjistruar në vitin 2016.

Ndërkohë vazhdojnë të kenë numër të lartë edhe procedimet penale të regjistruara për veprat penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, 46 procedime penale, vepra penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, 30 procedime penale, vepra penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, 23 procedime penale dhe vepra penale e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, 13 procedime penale.


Tabela më poshtë pasqyron treguesit për këto vepra penale krahasuar me treguesit e vitit 2016.

Viti	Neni 134	Neni 130/a	Neni 199/a	Neni 290	Neni 291	Neni 283	Neni 284	Neni 151
2016	124	29	21	30	45	22	60	3
2017	155	34	42	30	46	13	23	22

Tregues të tjerë të efektivitetit të ndjekjes penale.

Treguesit që analizuam më sipër, flasin për efektivitet të ndjekjes penale, në kuptimin jo vetëm të përballimit të një ngarkese dhe volumi të madh pune, por edhe në dhënien e zgjidhjeve të drejta e të bazuara në ligj dhe brenda afateve ligjore.

Gjatë vitit 2017, është vendosur pushimi i hetimeve për 67 procedime penale, nga të cilat 36 për mungesë fakti dhe 31 për shkaqe të tjera. Pushimi i procedimeve rezulton të jetë vendosur për 12.5% të procedimeve të zgjidhura në total gjatë vitit 2017. Një numër të konsiderueshëm zënë pushimet e procedimeve të rifilluara, për të cilat është vendosur pushimi për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Pushimi i hetimeve është vendosur për 10 persona nën hetim ku asnjëri nuk rezulton të jetë me masën e sigurimit “arrest në burg”.



Pushimi i hetimeve rezulton se është vendosur për 13 procedime penale të regjistruara për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal me 6 persona nën hetim, për 9 procedime penale të regjistruara për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal kryesisht për parashkrim të ndjekjes penale. Vetëm një procedim rezulton të jetë i pushuar për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, me një person nën hetim. Pushimi i hetimeve është vendosur për 5 procedime të regjistruara për veprën penale “Përdorimi me keqdashje të thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, për 5 procedime të regjistruara për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për 5 procedime penale të regjistruara për veprën penale “Ndertimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, 3 procedime penale të regjistruara për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullte”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal me 3 persona nën hetim, etj.


Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, për procedimet penale të regjistruara për krime, pushimi i hetimit të procedimeve penale është vendosur nga gjykata mbi kërkesën e prokurorit.

Në të gjitha rastet, kur pushimi i hetimeve është vendosur nga prokurori, vendimi i pushimit ju është njoftuar personave të interesuar, kallëzuesit, personit nën hetim, personave të demtuar, si dhe Komisarit të Policisë e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhe kur këto subjekte kanë qenë referues të materialeve.

Gjatë vitit 2017, në 2 raste gjykata ka shfuqizuar vendimet për pushimin e hetimeve të vendosura nga prokurorët, 1 rast i prokurores Ajola Prençi (procedimi penal nr.17/2017, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal), dhe 1 rast i prokurorit Arben Nika (procedimi penal në ngarkim të personit nën hetim K.B., i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal).

Gjatë vitit 2017, janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin 223 procedime penale, me 256 të pandehur, 154 prej të cilëve me masën e sigurimit arrest në burg.

Procedimet e dërguara për gjykim përbëjnë 41 % të zgjidhjeve të dhena në këtë prokurori për vitin 2017, duke përfshirë këtu procedimet e pezulluara, procedimet e pushuara dhe ato të transferuara prokurorëve të tjera.



Krahasuar me vitin 2016, numri i procedimeve të derguara për gjykim, në statistikë rezultojn të jëtë më i ulët me rreth 20 procedime penale. Gjatë vitit 2016 u dërguan për gjykim 243 procedime penale me 272 të pandehur, 107 prej të cilëve janë ndjekur me masën e sigurimit “arrest ne burg”.

Treguesi i procedimeve penale të derguara për gjykim gjatë vitit 2017, spjegohet me procedurën e zgjatur pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, dhe me faktin se për një numër procedimesh për të cilët prokurorët kishin konkluduar për dërgimin në gjykim, deri në mbyllje të vitit 2017, Gjykata nuk kishte shqyrtuar të gjitha kërkesat për dërgimin e procedimeve për gjykim. Kështu, në gjykatë rezultojn se u dërguan 67 kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim dhe deri në përfundim të vitit u shqyrtuan vetëm 32 kërkesa, duke mbetur të pashqyrtuara 35 kërkesa të tjera. Në këtë mënyrë, numri i procedimeve për të cilët prokurorët gjatë vitit 2017 konkluduan për dërgimin në gjykim, rezultojn të jetë 258 procedime penale, pra më i lartë se ai i vitit 2016.

Pas 1 gushtit të këtij viti, për shkak të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, prokurorët i janë drejtuar gjykatës me 67 kërkesa për dërgimin e çështjeve për gjykim. Gjykata ka shqyrtuar 32 kërkesa, ka pranuar 31 kërkesa dhe vetëm në një rast ka vendosur kthimin për plotësim.

Gjithashtu prokurorët për 3 procedime kanë dërguar në gjykatë marëveshjet më të pandehurit nga të cilat gjykata ka shqyrtuar 2 prej tyre duke i pranuar ato.

Po kështu, në 2 raste prokurorët kanë dërguar për miratim në gjykatë urdhërat penal për procedime penale të regjistruara për kundravajtje. Gjykata ka shqyrtuar njërin nga urdhërat penal dhe e ka pranuar atë.

Nga procedimet e dërguara për gjykim, numrin më të madh e zënë procedimet për veprën penale të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal, 36 procedime për këtë veprë penale, 35 procedime për veprën penale “Dhuna në familje“, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, 22 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, 10 procedime për veprën penale “Mbajtja pa leje e armeve luftarake dhe e municionit“, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, 12 procedime për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor“ parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, 4 procedime për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike“, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, etj .

Tabela pasqyron këta tregues të shënuar gjatë vitit 2017 dhe ato të shënuara gjatë vitit 2016.

Viti	Neni 291	Neni 290	Neni 130	Neni 199/a	Neni 278	Neni 284	Neni 283	Neni 137
2016	44	20	25	15	17	6	6	19
2017	36	12	35	22	10	4	=	6

Ndërkohe, rezultojnë se në gjykim nga viti 2016 ishin mbartur 27 procedime, me 29 të pandehur, prej të cilëve 6 me masën e sigurimit “arrest në burg“. Kështu prokurorët gjatë vitit 2017 kanë përfaqësuar akuzën në gjykim në 250 procedime penale, me 285 të pandehur, 160 prej të cilëve kanë qenë me masën e sigurimit “arrest në burg”.

Numri i lartë i procedimeve në gjykim për vitin 2017 dhe përballimi i këtij volume në gjykim, ka kërkuar angazhim të vazhdueshëm të prokurorëve, planifikim dhe ndjekje me korrektesë të seancave gjyqësore. Pjesëmarrja e prokurorit në gjykime ka qenë e plotë dhe efektive. Kjo ka bërë që për vitin 2017, të përfundojë gjykimi i 204 çështjeve penale, me 223 të pandehur, 137 prej të cilëve kanë qenë me masën e sigurimit “arrest në burg”.

Duhet theksuar se pjesëmarrja e prokurorit në gjykim gjatë vitit 2017 për shkak të ndryshimeve në Kodin e Procedurave Penale është shumë më e madhe se numri i procedimeve të gjykuara në këtë vit. Kjo për shkak se prokurori pas 1 gushtit të vitit 2017, në gjykimin e një procedimi merr pjesë edhe në seancat paraprake dhe më pas në seancat gjyqësore. Përveç kësaj pjesëmarrja e prokurorit tani është edhe për procedimet që dërgohen për pushim, pra prokurori përfaqëson jo vetëm akuzën në gjykimin e procedimeve penale të dërguara për gjykim por edhe merr pjesë dhe mbron kërkesat për pushimin e çështjeve penale të regjistruara për krime.

Nga viti 2017, u mbartën në gjykim 53 procedime penale, me 62 të pandehur, 23 prej të cilëve me masen e sigurimit “arrest ne burg“.

Përfaqësimi i akuzes në gjykim per vitin 2017 duhet vleresuar pozitiv. Gjykata përgjithësisht ka gjetur të drejte dhe të bazuar në ligj e prova akuzat e ngritura nga prokurorët dhe kërkesat e tyre.

Për vitin 2017, gjykata në gjykimin ë një procedimi penal me 6 të pandehur, për një të pandehur, të pandehurin O.M, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1, ka dhënë pafajësi. Akuzën në këtë gjykim e ka përfaqësuar prokurori Arben Nika. Ky vendim është ankimuar por çështja nuk është gjykuar ende në apel.

Edhe në gjykimn e një çështje tjetër penale me 2 të pandehur, gjykata ka dhënë pafajësi për një të pandehur, të pandehurin Y.V, i akuzuar për veprën penalë të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Akuzën në këtë gjykim e ka përfaqësuar prokurori Arben Nika. Ky vendim është ankimuar por çështja nuk është gjykuar ende në apel.

Gjatë vitit 2017, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes për 21 çështje penale. Nga këto 18 pushime janë vendosur për aplikim të amnistise dhe 3 pushime janë vendosur në gjykimin e këtyre çështjeve penale.

Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes në gjykimin e çështjes penale në ngarkim te pandehurit E.Ç. , i akuzuar per vepren penale te parashikuar nga aneni 283/1 i Kodit Penal. Akuza në këtë gjykim është përfaqësuar nga prokurori Hysni Vata, i cili ka kërkuar vetë pushimin e gjykimit për këtë procedim për shkak të ekspertimit toksikologjik të kryer gjatë gjykimit

Pushim të çështjes gjykata ka vendosur edhe në gjykimin e çështjes penale në ngarkim te pandehurit H.V, i akuzuar per veprën penale te parashikuar nga neni 290/2/1 i Kodit Penal. Akuzën në këtë gjykim e ka përfaqësuar porkurori Hysni Vata, i cili ka ankimuar vendimin e gjykatës por ky ankim ende nuk është shqyrtuar në gjykatën e apelit.

Gjithashtu gjykata ka vendosur pushimin e çështjes ne gjykim në ngarkim të pandehurit F.H, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal. Akuzën në këtë gjykim e ka përfaqësuar prokurorja Ajola Prençi, e cila ka ankimuar vendimin e gjykatës por ky ankim ende nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tirane.

Gjykata ne gjykimin e procedimit penal ne ngarkim të pandehurit D.T , i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, përfaqësuar nga prokurori Bardhyl Shehu, mbi kërkesën e prokurorit ka vendosur kthimin e akteve prokurorit.

Gjatë vitit 2017, nga prokurorët është kërkuar dënimi me gjobë në 17 raste dhe është dhënë nga gjykata në 21 raste, dënimi me burgim në minimum nga prokurorët është kërkuar në 51 raste dhe është dhënë nga gjykata në 43 raste, dënimi me burgim në mesataren e dispozitës është kërkuar nga prokurorët në 111 raste dhe është dhënë nga gjykata në 74 raste, dënimi me burgim në maximum është kërkuar në 1 rast dhe është dhënë nga gjykata vetëm në këtë rast.

Nga prokurorët gjatë vitit 2017 nuk është kërkuar në asnjë rast aplikimi i nenit 53 të Kodit Penal, ndërkohë nga gjykata është aplikuar në 2 raste, aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal nga prokurorët është kërkuar në 29 raste dhe është dhënë nga gjykata në 67 raste.

Nga prokurorët është reaguar me apeline ndaj shumë vendimeve të dhëna nga gjykata, veçanërisht ndaj vendimit për pafajësi, vendimeve për pushimin e çështjeve dhe në disa raste ndaj aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal. Gjithsej gjatë vitit 2017, nga prokurorët janë bërë 48 apeline ndaj vendimeve të gjykatës dhe në 5 raste Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimet e gjykatës në favor të apelimit të bërë nga prokurorët, 4 raste mbi apelimet e prokurores Ajola Prenci dhe 1 rast i prokurorit Bardhy Shehu. Kuptohet që shumë nga apelimet e bëra nga prokurorët ende nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit.

Gjatë vitit 2017, prokurorët kanë paraqitur në gjykate dhe është bërë gjykimi i një numri të madh kërkesash të ndryshme penale si: - 64 kërkesa për vleftësim e lejim përgjimi dhe zgjatje afati, 5 kërkesa për kontroll banese, 2 kërkesa për vendosje mase sekuestro, 1 kërkesë për sigurim prove, etj.

Gjatë vitit 2017, vëmëndje dhe kujdes i është kushtuar edhe caktimit të masave të sigurimit personal. Në çdo rast kërkesa për caktimin e masës së sigurimit është bërë duke vlerësuar rrezikshmërinë e veprës penale të autorit, tendencat dhe përhapja e veprës penale, e rrethana të tjera që ka patur rasti.

Në total gjatë vitit 2017 janë ndjekur në hetim 649 procedime penale, me 88 persona nën hetim dhe 271 të pandehur, nga të cilët 183 kanë qene me masën e sigurimit arrest në burg.

Gjatë vitit 2017, arresti në flagrancë nga policia gjyqësore është vendosur për 156 persona dhe për 8 persona është ekzekutuar urdhër ndalimi, pra gjithsej 164 persona. Prokurori ka kërkuar në gjykatë vlerësimin e arrestit në flagrancë për 164 persona, duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit arrest në burg për 149 persona, ku në këtë numër përfshihen edhe 8 kërkesa për caktimin e arrestit në burg në mungesë, në 11 raste nga prokurori është kërkuar caktimi i masës së sigurimit arrest në shtëpi dhe në 23 raste ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore.

Gjykata ka vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe ndalimet, pra gjithsej 164 persona dhe ka caktuar për 72 persona masën e sigurimit arrest në burg, për 40 persona ka caktuar si masë sigurimi atë të arrestit në shtëpi, në 34 raste ka caktuar si masë sigurimi detyrimin për tu paraqitur në policinë gjyqësore.

Volumi i punës i përballuar nga prokurorët gjatë vitit 2017 dhe zgjidhjet e dhëna prej tyre.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin gjatë vitit 2017, funksionin e prokurorit e kanë ushtruar prokurori Hysni Vata i cili ka qenë Drëjtues i Prokurorisë deri me 15.07.2017, prokurorja Ajola Prençi, prokurori Arben Nika, prokurori Bardhyl Shehu, prokurori Bujar Cici i komanduar nga muaji shtator e në vazhdim dhe prokurori Zeqir Hoda Drejtues i Prokurorisë i komanduar nga data 18.07.2017 e në vazhdim. Këta prokuror kanë drejtuar hetimin në total të procedimeve penale të ndjekura gjatë vitit 2017 dhe kanë dhënë zgjidhjet që pasqyrojnë më sipër. Gjithashtu prej tyre është mbuluar edhe përfaqësimi i akuzës në gjykim dhe gjithë marëdhëniet me gjykatën gjatë këtij viti. Por në mënyrë të detajuar volumin e punës të përballuar nga secili prej tyre dhe zgjidhjet që ata kanë dhënë po i pasqyrojmë në tabelën më poshtë:

Prokur	Mosf	Push	Pez	Trans	Gjyk	Gjyk. Marv	Urdh. Penal	Total Gjyk-	Proc. Perf	Mbart hetim
H.Vata	7	5	12		16			16	33	
B.Shehu	103	12	77	6	76			76	171	40
A.Nika	83	15	70		66	1		67	158	30
A.Prençi	81	23	52	11	55	2	1	58	144	22
B. Cici		11			3			3	14	21
Z.Hoda	3	1	8	2	3			3	14	2
Total	277	67	219	25	219	3	1	223	534	115

Pas 1 gushtit të vitit 2017, prokurorët kanë drejtuar në gjykatë kërkesat për pushimin e procedimeve penale të regjistruara për krime dhe kërkesat për dërgimin e procedimeve penale për gjykim.

Tabela paraqet këto kërkesa të prokruorëve në gjykate.

Prokur	Kerkesa per pushim	Kerkesa për dërg. Gjyk.
H.Vata		
B.Shehu	3	20
A.Nika	1	18
A.Prenci	6	23
B. Cici	31	3
Z.Hoda	1	3
Total	42	67

Hetimi dhe policia gjyqesore gjatë vitit 2017.

Hetimi për vitin 2017, është mbuluar nga oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë dhe nga oficeret e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë e të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë. Përgjithësisht, delegimi i procedimeve penale është bërë sipas sugjerimit që kanë bërë Komisaritati i Policisë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, duke u deleguar procedimet oficerëve që kanë referuar materialin dhe kanë kryer veprimet kryesore procedurale dhe hetimore. Në disa raste sugjerimi për delegim është bërë për oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit që mbulojnë zonën ku ka ndodhur vepra penale.

Në seksionin e policisë gjyqësore të strukturës pranë prokurorisë, gjatë vitit 2017 kanë punuar oficerët e policisë gjyqësore Nik Ndoci, Erind Gjoni, Erenik Muhametaj si dhe oficeri i policisë gjyqësore i komisarariatit të policisë Nikolin Marku. Oficerët e këtij seksioni, gjatë vitit 2017, kanë kryer veprimet verifikuese për shumicën e materialeve në fazën verifikuese si dhe kanë ndjekur në hetim procedimet penale të regjistruara mbi kallëzimet e qytetarëve dhe procedime të tjera të referuara nga policia.

Por gjatë vitit 2017, oficerët e policisë gjyqësore të strukturës së prokurorisë krahas me hetimin janë ngarkuar edhe me detyra të tjera sipas nevojave që ka diktuar puna në sektor të ndryshëm të Prokurorisë. Kështu oficeri i policisë gjyqësore Nik Ndoci ka qenë i ngarkuar edhe me ekzekutimin e vendimeve penale, ku ka mbuluar mbajtjen e regjistrit të ekzekutimit të vendimeve penale, mbajtjen e praktikave të ekzekutimit të vendimeve penale në dinamikën e tyre, etj.

Puna e policisë gjyqësore e strukturës pranë prokurorisë dhe e atyre prane Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, vlerësohet pozitivisht, jo vetëm për dokumentimin e mirë të veprave penale por edhe për hetimin me shpejtësi e pa zvarritje të procedimeve penale.

Tabela më poshtë pasqyron ngarkesën e oficerëve të policisë gjyqësore pranë prokurorisë për vitin 2017.

Zgjidhja	Mosf.	Pez.	Push	Transf.	Gjykatë	Hetim	Gjithsej
E.Gjoni	7	10	4		33	10	57
N.Ndoci	20	10	7		48	10	75
Erenik Muhametaj	18	7	14	-	48	4	73

Ndjekja dhe ekzekutimi i vendimeve penale ka qenë drejtim tjetër i rëndësishëm i punës tonë për vitin 2017.

Ekzekutimi i vendimeve penale gjatë vitit 2017 (deri në muajin tetor) është mbuluar nga prokurorja Ajola Prenci. Nga muaji tetor e në vazhdim me ekzekutimin e vendimeve penale ka qenë i ngarkuar prokurori Bujar Çiçi.

Gjatë këtij viti janë nxjerrë 100 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve me burgim, 22 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve me gjobe, 4 urdhëra për denime plotësuese, 59 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale sipas nenit 59 të Kodit Penal dhe 5 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal.

Gjatë vitit 2017, janë ekzekutuar 77 vendime me burgim, ngelen të pa ekzekutuara 24 vendime me burgim të këtij viti, janë ekzekutuar 8 vendime me dënim me gjobë, ngelen të pa ekzekutuara 15 vendime me dënim me gjobë, janë ekzekutuar 15 vendime me pezullim të ekzekutimit të denimit me burgim sipas nenit 59 të kodit Penal, ngelen të pa ekzekutuara 41 vendime të tjera dënimi me aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, janë ekzekutuar 3 vendime

dënimi me aplikim të nenit 59/a të Kodit Penal dhe 3 vendime dënimi me aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, ngelen edhe 2 vendime dënimi me aplikim të nenit 63 te pa ekzekutuara.

Gjate vitit 2017, prokurorja Ajola Prençi ka ndjekur deri ne muajin tetor edhe maredhëniet juridiksionale me jashte. Me pas maredhëniet juridiksionale me jashtë janë ndjekur nga prokurori Arben Nika.

Gjatë këtij viti, janë dërguar në gjykatë 3 kërkesa për njohje të vendimeve penale të gjykatave të huaja, të cilat jane shqyrtuar dhe pranuar nga gjykata sipas kërkesës së prokurorit.

Po kështu është dërguar në gjykatë edhe një kërkesë për ekstradim për jashtë por ende nuk ka përfunduar shqyrtimi i saj.

Gjatë vitit 2017 është dërguar në gjykatë 1 kërkesë për ekstradim nga jashtë e cila është pranuar nga gjykata.

Po kështu gjatë vitit 2017, jane ekzektuar 12 letër porosi nga jashtë dhe 2 letër porosi për jashtë.

Administrata e Prokurorisë gjatë vitit 2017.

Administrimi i regjistrave penal gjatë këtij viti kryesisht është bërë nga Kryesekretarja Esi Kola, e cila ka administruar edhe Sistemin CAMS dhe ka mbajtur edhe statistikat elektronike. Kryesekretarja Esi Kola ka qenë e ngarkuar edhe me veprimtarinë financiare të prokurorisë.

Me administrimin e dokumentacionit, protokollit dhe arkivit ka qenë e ngarkuar sekretarja Adelina Gjoni, e cila për periudhen e tre mujorit të parë ka qenë e ngarkuar edhe me vprimtarinë financiare të institucionit.

Rol në mbarëvajtjen e gjithë punës në Prokurori gjate vitit 2017 kanë patur edhe punonjësit e tjerë të administrates, marangozi Ardian Kosumi, i cili përveç detyrës së tij është angazhuar dhe ka kryer edhe detyra të tjera të rëndesishmë duke punuar edhe jashtë kohës normale të punës për t'ju përgjigjur ngarkeses së rritur dhe ritmit te shtuar të punës në prokurori, shoferi Nikolin Gjetani dhe sanitarja Marjana Buzali.

Ushtrimi i rolit dhe kompetencave të Drejtuesit të Prokurorisë.

Veprimtaria e prokurorisë gjatë vitit 2017 në ushtrimin e ndjekjes penale dhe perfaqësimin e akuzes në gjykim, natyrisht që është e lidhur edhe me rolin e Drejtuesit të Prokurorisë në këtë veprimtari. Nga ana ime si drejtues i kësaj prokurorie është ndjekur dhe kontrolluar në vijimësi e gjithë veprimtaria e Prokurorisë, duke kërkuar në çdo rast zbatimin e drejtë të ligjit material dhe atij procedural penal.

Jam përpjekur të zbatojë të gjitha detyrimet ligjore që Drejtuesit të Prokurorisë ja ngarkon Ligji Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë” dhe detyrimet e tjera të Kodit të Procedurës Penale.

Kam vlerësuar si moment të rëndësishëm vënien në lëvizje më shpëjtësi të kallëzimeve dhe procedimeve penale, duke caktuar menjëherë pas shortimit të materialeve, oficerin e policisë gjyqësore të ngarkuar me hetimin dhe duke ja kaluar pa vonesë materialin prokurorit përkatës. Në çdo rast kjo procedurë është dokumentuar me një formular të posaçëm që i bashkohet kallëzimit apo procedimit penal dhe në vazhdim është vijuar më regjistrimet e procedimeve penale dhe vijimin e hetimeve të tyre.

Vëmendje nga ana ime si drejtues i është kushtuar dokumentimit të të gjithë procesit të ndjekjes penale, nëpërmjet mbajtjes dhe plotësimit të regjistrave të ndryshëm, si ai i regjistrimit të Kallëzimeve, Regjistri i Veprave Penale, Regjistri i Përgjimeve etj, duke caktuar personat përgjegjës për mbajtjen këtyre regjistrave dhe duke e kontrolluar në vijimësi këtë proces.

Për të patur gjithnjë të dhëna të shpejta dhe të sakta për treguesit e ndjekjes penale, kam organizuar punën për pasqyrimin e gjithë kësaj veprimtarie edhe në statistika elektronike, madje duke plotësuar këto statistika edhe për periudha të viteve të mëparshme. Ky proces rezultoi i nevojshëm edhe për plotësimin e saktë të statistikave periodike që i dërgohen edhe Prokurorisë së Përgjithshme, por edhe për procesin e nxjerrjes së të dhënave për shortin profesional të prokurorëve.

Duke vlerësuar ngarkesën e punës që ka patur çdo prokuror, aftësitë e secilit prej tyre dhe problemet e ndryshme që janë evidentuar, me urdhëra të posaçëm kam bërë caktimin e prokurorëve të ngarkuar për ekzekutimin e vendimeve penale dhe për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, si dhe organizimin konkret të punës në këto drejtime dhe në drejtime të tjera që ka aktiviteti i prokurorisë.

Kontrolli në dinamikë i ndjekjes penale ka qenë një nga drejtimet më të rëndësishme të punës time si Drejtues i Prokurorisë. Me stafin e prokuroreëve, për shkak edhe të një raporti të drejt pune me ta, kemi diskutuar vazhdimisht, si me kërkesën time në rastet kur e kam vlerësuar të nevojshme por edhe me kërkesë të tyre për procedime të ndryshme që ata kanë patur në ndjekje për probleme të ndryshme që kanë dalë në hetim. Pothuaj për të gjitha procedimet që kanë patur problematikë të ndryshme hetimi apo në përfundim të hetimeve, kemi diskutuar lidhur me gjendjen e hetimit, të provave të grumbulluara dhe për zgjidhjen ligjore të tyre. Për shkak të kësaj praktike pune, gjatë periudhës 6 mujore nuk jam gjendur para situatave për të urdhëruar me shkrim kryerjen e veprimeve për ndonjë procedim penal, por kemi konkluduar në çdo rast për veprimet e tjera të nevojshme që duheshin kryer .

Në takimet e përditshme me prokurorët është diskutuar edhe ecuria e gjyqimit për procedime të ndryshme dhe veçanërisht e atyre që ishin për vepra të rënda penale apo për vepra penale me impakt shoqëror

Sipas rasteve nga ana ime si drejtues është bërë zëvendësimi i prokuroreëve si për shkak të lëvizjes së prokuroreëve në këtë prokurori, por edhe në rastet e shqyrtimit të kërkesave për zëvendësim të tyre, duke arsyetuar në çdo rast dhe kthyer përgjigje kërkuarëve.

Objekt i rëndësishëm i punës time ka qenë veprimtaria e policisë gjyqësore, si e seksionit pranë prokurorisë ashtu edhe e policisë gjyqësore të strukturave të policisë së shtetit. Në vijimësi kam organizuar takime me drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë dhe të Komisarariatit të Policisë Kurbin. Këto takime kanë qenë për ngjarje të ndryshme me impakt shoqëror që për rrethin e Kurbinut janë të shpeshta, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me krimin kundër jetës, ashtu edhe për probleme të ndryshme që janë evidentuar lidhur me funksionimin e policisë gjyqësore në ndjekjen penale. Mendoj se kjo praktikë punë ka mbajtur të angazhuar me hetimin jo vetëm oficeret e policisë gjyqësore të ngarkuar me të por edhe drejtuesit e policisë, ku këta të fundit kanë qenë më aktiv dhe janë ndjerë më me përgjegjësi për hetimin dhe rezultatin e tij.

Marëdhënia me publikun dhe qytetarët ka qenë drejtim tjetër që unë si drejtues kam vlerësuar në veprimtarinë time. Në asnjë rast qytetarët nuk janë lënë të presin, por është organizuar puna që ata të marrin takim me personin që rezultonte përgjegjës për problemin që ata kanë patur, duke administruar në kohë problemin e tyre dhe më pas duke ndjekur dhe zgjidhur atë. Nga ana ime si drejtues është kërkuar dhe këmbëngulur me gjithë stafin e prokurorisë, që për çdo ankim dhe kërkesë të qytetarëve, të disponojnë përgjigje me shkrim duke ja dërguar atë qytetarit ankues apo kërkuar.

Urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm janë punuar dhe diskutuar ne takimet me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore dhe ne vijëmesi është ndjekur zbatimi i tyre.

Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin ne vazhdim dhe rekomandime.

Analiza e punës dhe treguesve të shënuar për vitin 2017 është edhe në funksion të evidentimit të drejtimeve kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin në vazhdim 2018, duke përcaktuar prioritetet kryesore dhe duke bërë përmirsimet e nevojshme.

-Hetimi dhe gjithë veprimtaria e policisë gjyqësore duhet shënoje përmirsimet të ndjeshme cilësore, pasi kjo lidhet direkt edhe me rezultatin e ndjekjes penale. Këtë e dikton edhe problemi që rezultoi në këtë analizë, zbulueshmëria e ulët e krimit e cila ka ardhur ne rritje ndër vite. Prokurorët, por veçanërisht oficerët e opolicisë gjyqësore është e nevojshme të punojnë për ngritjen e tyre profesionale, për njohjen më mirë te ndryshimeve ne ligjin material dhe ate procedural penal, si dhe të metodave dhe teknikave te hetimit për veprat e renda penale, ato të korrupsionit dhe të atyre që rezultojnë me përhapje të gjërë.

-Ndjekja ne vijëmesi e hetimeve nga ana e prokuroëve, për të patur dijeni në çdo moment për gjendjen e hetimit dhe të provave, si dhe për te nderhyre në kohë për kryerjen e veprimeve të tjera që dikton dinamika e hetimit, është drejtimi tjetër i rëndësishëm për veprimtarinë e prokurorisë për vitin në vazhdim. Natyrisht që oficerët e policisë gjyqësore duhet të mbajne ne dijeni prokurorin për veprimet që ata kryejnë, nëpërmjet komunikimve të vazhdueshme dhe informacioneve që duhet të përpilojnë në rastet e procedimeve komplekse apo kur këto kërkohen nga prokurorët. Mbi këto informacione, prokurori duhet të orientojë drejt veprimtarinë hetimore duke nxjerre edhe aktet e nevojshme procedurale për kryerjen e veprime specifike si, kontrole, përgjime etj. Gjithashtu prokurori duhet të nxisë policinë gjyqësore për një hetim dinamik, të shpejtë dhe të gjithëanshëm. Prokurori duhet të evidentojë konkretisht dhe përcjellë me informacione Drejtuesit të Prokurorisë për problematika të veçanta dhe pengesa të ndryshme që kanë të bëjnë me mënyrën e funksionimit të organizimit të punës së veprimtarisë hetimore, zvarritjet e pajustificueshme, etj.

-Përmirsimet duhen shënuar edhe lidhur me dokumentimin e gjeneraliteteve të plota dhe të adresave të sakta të banimit, jo vetem për personat ë dyshuar si autor, por edhe për personat që rezulton se janë cenuar nga vepra penale, jane te demtuar, viktima të veprës penale dhe trashgimtar të këtyre te fundit. I gjithë procesi penal, vecanërisht pas ndryshimeve të

rëndësishme të Kodit të Procedurës Penale, kërkon njoftimet për këta persona dhe mbajtjen në dijeni të tyre, por për shkak të praktikave të deritanishme, rezulton se ka vështësi në gjetjen dhe njoftimet e tyre.

Prioritet e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2018.

Se pari, prioritet i veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin do të vazhdojë të mbetet hetimi i procedimeve penale për veprat e korrupsionit, ato të pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale dhe për veprat penale kundër jetës dhe kundër pronës, ku këto të fundit janë edhe me përhapje të gjërë. Natyrisht, ky prioritet do të kërkojë jo vetëm angazhim më të mirë të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, por do të kërkojë edhe përmirsim të punës dhe praktikave që ndiqen për këto hetime. Përmirsimet duhen bërë në drejtim të aplikimit të metadave proaktive të hetimit duke shtuar aplikimin e këtyre metodave dhe rregulluar këtë aplikim, duke vlerësuar në çdo rast zbatimin e normimeve procedurale për to.

Së dyti, prioritet i rëndësishëm i punës tonë për këtë vit në vazhdim do të jetë respektimi i Kodit për të Mitur dhe i ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale për hetimin e procedimeve me të mitur të pandehur dhe viktimë, për shkak se normimet e reja do të kërkojnë hetimin e këtyre procedimeve nga secila prokurori. Prokurorët dhe veçanërisht prokurori i caktuar për hetimin e procedimeve me të mitur duhet që në vazhdimësi të mbajë nën kontroll veprimet procedurale dhe ato hetimore me të mitur dhe të organizojë takime me oficerët e ngarkuar me këto hetime. Kryerja e trajnimeve të vazhdueshme për njohjen e Kodit për të Mitur dhe të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale duhet të përfshijë të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.

Së treti, organizimi i analizave të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore dhe drejtuesit e policisë gjyqësore të strukturave të policisë së shtetit në funksion të rritjes së zbulueshmërisë të autoreve të veprave penale, do të jetë prioritet tjetër i veprimtarisë tonë në vazhdim. Këto analiza dhe takime duhet të shoqërohen me përcaktime të veprimeve konkrete që duhen kryer, veçanërisht për procedimet e pezulluara për vepra të rënda penale me qëllim grumbullimin e të dhenave për rifillimin e hetimit, identifikimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të tyre.

Në funksion të realizimit të këtyre përmirsimëve dhe të ndjekjes me sukses edhe të prioriteteve, gjykuar edhe nga numri i materialeve dhe referimeve që përgjithësisht administrohen në këtë prokurori, numri i procedimeve penale që trajtohen në një vit, si dhe ndjekja e gjithë veprimtarisë tjetër administrative e procedurale, ndjekja e ekzekutimit të

vendimeve penale, marëdhëniet juridikionale me jashtë, si dhe ndjekja e regjistrimit të veprave penale, kërkojnë vazhdimisht që në këtë prokurori të jenë në punë 4 prokuror.

Gjithashtu veprimtaria e shtuar me mbajtjen e Sistemit CAMS, të regjistrave penal, statistikave elektronike, të regjistrimit të ekzekutimit të vendimeve, marëdhëniet juridikionale me jashtë, statistikave përkatëse, kërkojnë gjithashtu shtimin të pakten edhe të 1 sekretare që të mbulojë një pjesë të kësaj veprimtarie.

Kjo ishte tabloja e punës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin për vitin 2017, e cila mendojmë se do të plotësohet edhe më tej, me diskutime e sugjerime, nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore si dhe të ftuarit.

DREJTUESI I PROKURORISË

Zeqir HODA